



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 516/1 Prot.

Tiranë, më 22 / 04 / 2021

V E N D I M

Nr. 66 , Datë 22 / 04 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 60, datë 18.04.2021, të shtetasit D. H kundër: Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), pranë Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjeve politike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, subjekti ankues është ankuar pranë institucioneve të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT)/Bashkia Tiranë, për një ndërtim të paligjshëm zaptues, i cili ndodhet rreth 30 cm larg ballkonit të banesës së tij.

Ankuesi shprehet se: *“Ky ndërtim i paligjshëm u ka vështirësuar banimin të gjithë banorëve të pallatit tim, si dhe të tre-katër pallateve aty pranë, pasi përbën rrezik në rast tërmeti, zjarri etj. Ndërtimi i ka bashkëngjitur dhe një mur rrethues pallateve aty ngjitur. Ky ndërtim zaptues, tip magazine prej rreth 250 m² ka më shumë se 20 vite që qëndron aty “i patundur” në një nga zonat më urbane të Tiranës, pa leje, pa qenë në proces legalizimi, pa asnjë lloj dokumentacioni, i furnizuar me ujë dhe energji elektrike pa kontratë nga UKT dhe OSHEE, pra në mënyrën më informale të mundshme, duke vjedhur ujin dhe energjinë.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Përgjigjet e këtyre institucioneve janë të pabazuara në ligj. Jo vetëm nuk është ndërhyrë për prishjen e tyre siç e urdhëron ligji, por nuk është marrë asnjë masë administrative apo dërgimi i rastit në Prokurori”.

Ankuesi ka pretenduar se arsyeja e vërtetë e kësaj shkeljeje flagrante ligjore është fakti se pallati në të cilin ai banon është pallati i ish-gazetarëve të “RD-së”, si dhe fakti që ai është një kritik i kësaj qeverie përmes shkrimeve të tij. Për këtë shkak ankuesi ka pretenduar se diskriminohet duke u përndjekur politikisht.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve të tij politike, nga ana e dy institucioneve: IKMT dhe IMT/Bashkia Tiranë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, si dhe legjislacionit përkatës, vërejmë se:

IMT ndjek dhe zbaton hapat ligjorë të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, të ndryshuar, vetëm për ndërtimet pa leje që janë ndërtuar pas datës 27.06.2014 ose janë në proces ndërtimi, pasi për të gjithë ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më datë 27.06.2014, zbatohet ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, i ndryshuar.

Në nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar, parashikohet se: *“1. Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj... 4. Të gjitha ndërtimet e tjera pa leje, të cilat nuk u përgjigjen kushteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, trajtohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit, të ndryshuar.”*

Referuar deklarimeve të subjektit ankues, ndërtimi i paligjshëm, i cili është objekt shqyrtimi, rezulton të jetë ndërtuar para rreth 20 viteve, pra përpara vitit 2014.

Në këtë kontekst, mbështetur në parashikimin ligjor të sipërcituar, konstatohet se ndërtimi sipërcituar, është objekt i ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar.

Në nenin 5 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar, parashikohen detyrat e njësisë së qeverisjes vendore, duke përcaktuar se: *“ Sipas këtij ligji, njësia e qeverisjes vendore ka këto detyra: ... “ b) identifikon në terren ndërtimet pa leje, për të cilat nuk është bërë vetëdeklarimi, identifikon të gjitha rastet eventuale të ndërtimeve pa leje, të kryera pas miratimit të këtij ligji dhe nis procedurat për prishjen e tyre, sipas ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit””*.

Neni 4 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, parashikon përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, ku ndër të tjera citohet se: *“Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë*

vendore përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.”

Bazuar në deklaratimet e subjektit ankues, Komisioneri vëren se, problematika e ngritur prek jo vetëm ankuesin, por të gjithë banorët e pallateve aty rrotull dhe se pretendimi i tij për: mosndërhyrjen e institucioneve përkatëse për prishjen e ndërtimit të paligjshëm, mosmarrjen e masave administrative ndaj subjekteve që disponojnë ndërtiminin e paligjshëm apo dërgimin e rastit në Prokurori; nuk bën pjesë në kompetencat lëndore të KMD-së.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vëren se, edhe nëse pretendimi i ankuesit për ndërtim të paligjshëm merret si i qenësishëm, situata e krijuar për shkak të këtij ndërtimi, është një situatë që prek të gjithë banorët e pallateve rrotull pallatit të tij dhe jo vetëm ankuesin, pra është një situatë e krijuar prej rreth 20 vitesh dhe ekziston, pavarësisht shkakut individual të pretenduar nga ankuesi (bindjet politike) dhe e pandikuar nga ai.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesi ka pretenduar për paligjshmëri dhe mosveprim të IMT/Bashkia Tiranë, pretendim i cili mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi ndodhemi në kushtet e një konflikti të mirëfilltë civil të ankuesit dhe banorëve të pallateve të tjera të asaj zone me institucionin e IMT/Bashkia Tiranë, në këtë rast. Pretendimi për

² Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

paligjshmëri të veprimeve apo mosveprimeve të IMT/Bashkia Tiranë nuk bën pjesë në kompetencat lëndore të KMD-së.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e tij për mosreferimin e rastit në Prokurori nga ana e IMT/Bashkia Tiranë, Komisioneri i sugjeron ankuesit se mund të ndjekë procedurën ligjore pranë organit të Prokurorisë, i cili në bazë të Kushtetutës dhe ligjit është organi kompetent që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë.

Neni 199/a³ i Kodit Penal, të ndryshuar, sanksionon se: *“Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet”.

Përfundimisht, për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon shprehimisht se, ankesa nuk pranohet nëse: *“është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c/ç dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit D. H, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

³ “Ndërtimi i paligjshëm”.

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Bindjet politike
Lloji i vendimit: Mospranim